

(K. Ankimore 42)

KËRKESË ANKIMORE

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova" nr. 4, Tirana

Nv. prot 2365  
Dt 31.3.2023  
ora 18:30

<b>ANKUESI</b>	
<b>Subjekti Zgjedhor</b>	<b>Partia Socialiste e Shqipërisë</b>
<b>Adresa:</b> Adresa: Sheshi "Austria", Nr. 91. Tiranë	

<b>OBJEKTI I ANKIMIT</b>	
1. Ndryshimin e Vendimit Nr. 31, datë 28.03.2023 të K.Z.A.Z Nr.90, Sarandë. 2. Mosregjistrimin e kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore z. Gjergj Filip Merkuri.	
<b>2.KUNDËRSHTIMI I VENDIMIT TË K.Z.A.Z NR.90, SARANDË</b>	
<b>Vendimi</b>	
<b>Nr.31</b>	<b>Datë 28.03.2023</b>
<b>TITULLI I VENDIMIT</b>	
<b>PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT TË PROPOZUAR          NGA ZGJEDHËSIT PËR KRYETAR TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE GJERGJ          FILIP MERKURI</b>	

Kërkesë ankimore

<b>PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR</b>	
1. Konstatohet shkelje flagrante e nenit 70 e vijues të Kodit Zgjedhor të Shqipërisë, i ndryshur, në regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore Gjergj Filip Merkuri 1.1. Kandidati është regjistruar mbi bazë të nënshkrimeve të falsifikuar; 1.2. Kandidati është regjistruar në bazë të nënshkrimeve të personave të cilët nuk vendbanim Bashkinë Sarandë; 1.3. Kandidati është regjistruar në bazë të nënshkrimeve të personave të cilët janë mashtruar prej tij në lidhje me qëllimin e nënshkrimit.	



## **FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.**

1. Presidenti Republikës së Shqipërisë, me Dekretin Nr.13864, datë 24.10.2022 ka caktuar datën 14 Maj 2023, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore ne vendin tonë.
2. Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë (P.S.SH) garon në këto zgjedhje vendore në të gjitha zonat zgjedhore të vendit tonë ku përfshihet konkretisht edhe Bashkia Sarandë. Në këtë njësi të qeverisjes vendore PSSH garon me përfaqësuesij e saj Z. Olti Çaçi.
3. Gjatë procesit të regjistrimit të kandidatëve pranë K.Z.A.Z Nr.90, subjekti jonë ka konstatuar se nga ana e shtetasit Gjergj Filip Mërkuri ka paraqitur kandidaturën e tij si i propozuar prej zgjedhësve. Ai ka paraqitur kërkesën e tij pranë K.Z.A.Z Nr.90 Sarandë për regjistrim sipas nenit 70 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, duke prezantuar për regjistrim edhe anëtarët e Komitetit Nismëtar për këtë qëllim. Në përfundim të procesit të mbledhjes së nënshkrimeve Z.Mërkuri ka arritur të mbledhë 640 firma të qytetarëve.
4. Nga verifikimi që i është bërë dokumentacionit të mbledhur nga ky kandidat, konkretisht dokumentit të llojit "FORMULAR PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE TË ZGJEDHËSVE PËR MBËSHTETJE KANDIDATI" dhe në bazë të të dhënave të administruara më pas, janë konstatuar fakte, vërtetësia e të cilave sillte si pasojë mosregjistrim e tij nga K.Z.A.Z.

4.1.Kështu, është konstatuar dhe provuar se një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët kishin nënshkruar në listën e kandidatit Z. Mërkuri të paraqitura pranë KZAZ Nr.90, i'u është thënë se nënshkrimi në formularin që iu është paraqitur atyre kishte vlerë ligjore vetëm për të favorizuar personalisht atë në garë brenda P.S.SH për kandidaturën përfundimtare për kandidat për Kryetar Bashkie Sarandë dhe jo si kandidat i pavarur jashtë vullnetit të këtij subjekti. Pra, qytetarëve ne masë i'u është fshehur fleta e parë e formularit qe përmban të dhëna lehtësisht të identifikueshme për subjektin dhe llojin e kandidimit. Deklarimi mbi këtë fakt është dhënë nga vetë zgjedhësit emri i të cilëve figuron edhe tek lista e depozituar nga kandidati Mërkuri ne KZAZ Nr.90 Sarandë me qëllim regjistrimin e tij. Deklarimet janë dhënë nga data 23.03.2023 e deri me datën 29.03.2023 nga 119

4.2.Po ashtu, është konstatuar dhe provuar se lista emërore në themel të vendimmarrjes së KZAZ është e falsifikuar pasi ka persona konkret të cilët mohojnë që të kenë nënshkruar ndonjëherë lista emërore pro apo kundër kandidatit, apo subjektit zgjedhor P.S.SH. Ky fakt është deklaruar personalisht shtetasi Denis Isai.

4.3.Gjithashtu, është konstatuar se lista emërore e kandidatit përmbën nënshkrime të personave të cilët ndodhen jashtë shtetit prej kohësh dhe ky është një fakt i ditur botërisht prej shumë banorëve të qytetit Sarandë.

5. Në këto rrethana të provuara me prova shkresore, P.S.SH Dega Sarandë, me shkresën e saj Nr. 10 Prot. datë 28.03.2023 dhe Nr.Prot.42, datë 28.03.2023 të K.Z.A.Z Nr.90, Sarandë, lënda "Kërkojmë mosregjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit Gjergji Mërkuri", ka kërkuar verifikimin e vërtetësisë së fakteve në themel të kërkesës së kandidatit dhe më tej mosregjistrimin e tij.




6. Me shkresën tjetër Nr.11 Prot, datë 28.03.2023, Nr. Prot.46, datë 28.03.2023 të K.Z.A.Z Nr.90, Sarandë, lënda "Kërkojmë mosregjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit Gjergji Merkuri", i është vënë në dispozicion KZAZ lista emërore e 89 qytetarëve që kishin hequr dorë dhe revokuar mbështetjen për kandidimin e Gjergji Mërkurit si kandidat i pavarur, duke nënshkruar deklaratë me shkrim personalisht për këtë qëllim.
7. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të kërkesës së kandidatit Z. Mërkuri, KZAZ Nr.90, Sarandë, me vendimn objekt ankimi ka vendosur: *Regjistrimin e kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore Z. Gjergj Filip Mërkuri të propozuar nga zgjedhësit për bashkinë Sarandë.*
8. Subjekti zgjedhor P.S.SH, pasi u njoh me vendimin Nr.31, datë 28.03.2023 të K.Z.A.Z Nr.90, Sarandë, në bazë të nenit 70 të Kodit Zgjedhor të R.SH, të ndryshuar, të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor", miratuar me vendimin Nr.5/2020 të K.RR, brenda afateve tre (3) ditor të parashikuar nga neni 9 i Rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve" të ndryshuar, miratuar me vendimin Nr.3/2020 të K.RR dhe Udhëzimit Nr, 1 datë 18.01.2023, "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore" të K.SH.Z, nuk është dakord me vendimin në fjalë dhe parashtron kundërshtimet e tij.
9. Argumentat për pranueshmërinë e ankimit.

**9.1. Në lidhje me legjitimitetin e subjektit zgjedhor P.S.SH për ankimin e vendimit.** Procedura e regjistrimit të kandidatit me mbështetjen e zgjedhësve është një procedure administrative që zhvillohet nga K.Z.A.Z në përputhje me Kodin Zgjedhor, i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore të nxjerra nga K.Q.Z, sic janë Rregullorja për K.Z.A.Z dhe udhëzimi i K.SH.Z Nr.1, datë 18.01.2023. Ky i fundit ka parashikuar në nenin 9/1 se gjatë zhvillimit të seancës publike të verifikimit marrin pjesë edhe subjekte të tjera zgjedhore. Kjo nënkupton se procesi në fjalë nuk ka thjeshtë natyrë deklarative dhe kontrolli formal të nënshkrimeve nga ana e K.Z.A.Z-së por se ky proces mund të bëhet objekt kontesimi nga subjektet e tjera zgjedhore pjesëmarrëse në procedure, pasi këto nuk mund të konsiderohen thjeshtë si "spektatorë". Pra, subjektet zgjedhore që garojnë në zonën zgjedhore ftohen në këtë procedure pasi ato vlerësohen se kanë interesa të ligjshme zgjedhore për të mbrojtur nëpërmjet të drejtës së ankimit ndaj një vendimi të K.Z.A.Z që vjen si pasojë e vlerësimit të gabuar të rrethanave dhe fakteve. Një kandidaturë e regjistruar në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Zgjedhor, i ndryshuar e cënon thelbësisht procesin e konkurrencës në zgjedhje si edhe interesat ligjore të subjektit PSSH në zonën zgjedhore. Për sa kohë subjekti zgjedhor legjitimohet si pjesëmarrës në procedurën e verifikimit të nënshkrimeve, ai legjitimohet të ankimojë edhe vendimin e K.Z.A.Z-së për regjistrimin e kandidatit.

**10. Në lidhje me themelin e pretendimeve.** Kodi Zgjedhor i RSH, i ndryshuar, ka parashikuar rregulla mjaft të qarta për përgatitjen, zhvillimin dhe administrimin e zgjedhjeve në vendin tonë duke u ndërtuar mbi bazën e parimeve të shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe shumë të drejtave të tjera të mbrojtura nga Kushtetuta.

11. Përveç pjesëmarrjes në votime të subjekteve zgjedhore të organizuara në formë e strukturë si një parti politike, të mbështetura gjerësisht nga zgjedhësit e tyre me bindje partiake, Kodi ka garantuar që edhe



zgjedhës të tjerë që nuk kanë bindje partiake të caktuara, të kenë mundësinë që të përfaqësohen nga një kandidat që nuk është i lidhur me partitë politike.

12. Pjesa IV e Kodit, neni 70 ka parashikuar regjistrimin si subjekt zgjedhor të "Kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore". Sipas këtij parashikimi rezulton se një grup zgjedhësish **me banim në zonën zgjedhore** kanë të drejtën që të propozojnë një kandidat për kryetar bashkie ose një kandidat për këshillin vendor.

13. Në interpretim të neni 71/2 i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar ku parashikohet se "Zgjedhësit depozitojnë personalisht nënshkrimet e tyre në formularin tip. Formulari duhet të përmbajë identitetin e plotë të zgjedhësit, datëlindjen e tij dhe numrin telefonik të kontaktit. Bashkë me nënshkrimin, çdo zgjedhës depoziton edhe fotokopjen e letërnjoftimit të vlefshëm, të nënshkruar prej tij, e cila i bashkëngjitet listës. Në zbatim të nenit 69 të këtij Kodi, zgjedhësi duhet të jetë i regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse.", **kërkohet që zgjedhësi i) të nënshkruajë vetë personalisht dhe ii) të jetë i regjistruar në zonën zgjedhore apo ndryshe me banim në këtë zonë (neni 70 K.Z).**

14. Gjatë procesit të regjistrimit të kandidatit në K.Z.A.Z , P.S.SH ka ardhur në dijeni të faktit se zgjedhësve që kanë nënshkruar listat emërore nuk iu është treguar qëllimi i marrjes së nënshkrimeve. Sipas deklarimeve të tyre kandidati Z.Mërkuri i'u është prezantuar si pjesëmarrës në garë brenda P.S.SH Dega Sarandë dhe se mbështetja që ai do të merrte nga zgjedhësit nëpërmjet nënshkrimeve të tyre do t'a ndihmonte atë për të fituar kandidaturën apo të drejtën të përfaqësohte P.S.SH si forcë politike në zgjedhjet vendore. Në lidhje me këtë , deklarimet e zgjedhësve mbi faktin e mësipërm janë marrë në formë shkresore dhe i janë vënë në dispozicion me KZAZ Nr.90 Sarandë me shkresat Nr.10 dhe 11 Prot, datë 28.09.2023. Sipas deklaratave zgjedhësit në fjalë kanë revokuar mbështetjen ndaj tij. Në këtë kuptim, K.Z.A.Z-së i është kërkuar verifikimi i nënshkrimeve sipas parashikimeve të nenit 71/4 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.1, datë 18.03.2023 të K.SH.Z "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore".

15. K.Z.A.Z Nr.9, Sarandë, edhe pse ka patur dy (2) kërkesa nga subjekti zgjedhor P.S.SH për mosregjistrim të kandidatit, nuk ka kryer detyrat e saj, nuk ka kryer verifikimin e nënshkrimeve të mbështetësve për kandidatin e pavarur Z.Mërkuri. **Ky mosveprim i K.Z.A.Z-së bie në kundërshtim flagrant:**

a. **me nenin 71/4 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, që parashikon se "4. Procedura e verifikimit të nënshkrimeve është publike dhe bëhet në përputhje me modalitetet e përcaktuara me akt normativ nga KQZ-ja."**

b. **me nenin 15/1/a të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor", miratuar me vendimin Nr.5/2020 të K.RR që parashikon se " K.Z.A.Z-ja kryen këto detyra: a) përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në Z.A.Z sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga K.Q.Z"**

c. **me nenin 9 të Udhëzimit Nr.1, datë 18.03.2023 të K.SH.Z që parashikon se :**

1. **KQZ/KZAZ-ja cakton një seancë publike për verifikimin e nënshkrimeve në të cilën marrin pjesë përfaqësuesit e subjektit zgjedhor ose komitetit nismëtar, dhe/ose përfaqësuesit e subjekteve të tjera zgjedhore.**

2. Në datën dhe orën e përcaktuar nga KQZ/ KZAZ-ja për zhvillimin e seancës, administrata e KQZ-së/KZAZ-së disponon një kopje të formularit tip të plotësuar nga nënshkrimet mbështetëse.

3. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së për zgjedh në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve që mbështetin subjektin zgjedhor përkatës të kopjes së formularit tip të nënshkrimeve.

4. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së verifikon nënshkrimin e kandidatëve duke përcaktuar nëse nënshkruesit janë zgjedhës me vendbanim në zonat zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit.

5. Numri i nënshkrimeve të rregullta pjesëtohet me numrin që përfaqëson 5% të të gjitha nënshkrimeve të paraqitura. Numri që del nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin e nënshkrimeve të paraqitura. Rezultati që del nga këto veprime përfaqëson numrin e nënshkrimeve të rregullta në listën e paraqitur.

6. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve të rregullta është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.

16. Moskryerja e nga ana e K.Z.A.Z të detyrave të parashikuara në ligj dhe akte nënligjore të K.Q.Z për verifikimin e nënshkrimeve të cilat në mënyrë të padrejtë i kanë mundësuar regjistrimin kandidatit Z.Mërkuri konstatohet si një shkelje e rëndë e ligjit. Kjo do të thotë se regjistrimi i kandidatit në fjalë ka ardhur si pasojë e një procedure *nul*, absolutisht e pavlefshme.

17. Shmagia e K.Z.A.Z e procesit të verifikimit publik ka bërë që të mos konstatoheshin falsifikime tejet të renda që lidhem në nënshkrimin e formularit nga zgjedhës/shtetas të cilët nuk kanë qënë të pranishëm në qytetin e Sarandës në kohën e paraqitur ne formular. Ka persona në qytet të cilët dihet se kanë vite jashtë shtetit. Po ashtu ka patur persona të cilët kanë deklaruar se nuk e kanë nënshkruar formularin edhe pse janë banorë të Sarandës.

18. Sa më sipër vërtetohet se regjistrimi i kandidatit Gjergji Filip Merkuri është bërë në bazë të një vullneti të vesuar të zgjedhësve të bashkisë Sarandë dhe kjo bie ndesh me qëllimin e nenit 70 e vijues të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

19. Për sa më sipër, vendimi Nr. 31, Datë 28.03.2023 i K.Z.A.Z Nr.90 Sarandë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore Gjergj Filip Merkuri duhet të ndryshohet nga KAS dhe të vendoset mosregjistrimi i tij për shkaqet e parashtruar më sipër.



**PROVAT QË PARAQITEN  
DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.**

1. Vendimi Nr. 31, Datë 28.03.2023 i K.Z.A.Z Nr.90 Sarandë;
2. 119 deklarime me shkresw të thjeshta të nënshkuara pesonalisht nga zgjedhësit me banim në Bashkinë Sarandë;
3. Shkresa Nr. 10 Prot. datë 28.03.2023 dhe Nr.Prot.42, datë 28.03.2023 të K.Z.A.Z Nr.90, Sarandë;
4. Shkresa Nr. 11 Prot. datë 28.03.2023 dhe Nr.Prot.46, datë 28.03.2023 të K.Z.A.Z Nr.90, Sarandë;
5. **Kërkohet që të merren provat e tjera si:**
  - a. Dokumentet e kandidimit të Gjergji Filip Merkuri të administruara nga K.Z.A.Z Nr.90, Sarandë;
  - b. Libri i protokollit të mbledhjeve të K.Z.A.Z Nr.90, Sarandë, pjesa që lidhet me regjistrimin e kandidatures Gjergji Filip Merkuri;

**ANKUESI  
PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISË  
Përfaqësuesi me Autorizim  
ERIDIAN SALIANJI**



Tiranë me datë \_\_\_ / \_\_\_ /2023





NUMER ZGJEDHJEVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ Nr:	90
BASHKIA:	SARANDË

VENDIM	Nr: 31
Data:	28/03/2023
Ora:	17:00

**VENDIM**

PER SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT TË PROPOZUAR NGA  
ZGJEDHËSIT PËR KRYETAR TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE

GJERGJI FILIP MËRKURI  
(emër zënie mbledhje)

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 90 i ngritur për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.5.2023, në mbledhjen e datës 28.03.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës për regjistrimin e z/zj. GJERGJI FILIP MËRKURI  
(emër zënie mbledhje)  
si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore në bashkinë SARANDË, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023

Baza ligjore: Neni 33, shkronja "r", neni 35, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 90, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe konstatoi se kushtet e parashikuara në nenin 70, të Kodit Zgjedhor.

PLOTËSOHEN       NUK PLOTËSOHEN

**VENDOSI:**

1.  Regjistrimin       Mosregjistrimin

kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore z/zj. GJERGJI FILIP MËRKURI  
(emër zënie mbledhje)  
të propozuar nga zgjedhësit për bashkinë SARANDË

- Under këtë vendim mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.
- Në kopje e këtij vendimi dërgohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe një kopje i jepet kërkuarit.



PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË  
KRYETARI

Adresa Sheshi "Austria", Nr 91 Tirane, Tel&Fax +355 4 22 83 36 228474


Nr. 45 Prot.

Tiranë, më 08 10 2023

**AUTORIZIM I PËRGJITHSHËM**

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin 74/2012, 31/2015, 101/2020 dhe të Statutit të Partisë Socialiste të Shqipërisë, emëroj dhe caktoj si përfaqësues të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Sekretarin për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore **z.ERIDIAN SALIANJI**;

- a. të nënshkruajë vetë ose të autorizojë persona të tretë për të nënshkruar dokumentet për regjistrimin e Partisë Socialiste të Shqipërisë (P.S.SH) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (K.Q.Z); të nënshkruajë kërkesa ankimore pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (K.S.H.Z), Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (K.A.S) dhe Kolegjit Zgjedhor (K.Z) si dhe çdo kërkesë tjetër që do të nevojitet në organet drejtuese të K.Q.Z ose të autorizojë persona të tretë për të nënshkruar aktet e mësipërme dhe për të bërë përfaqësimin pranë këtyre organeve me tagra të plota pa kufizim për mbrojtjen e interesave zgjedhore të P.S.SH, sipas përmbajtjes së Kodit Zgjedhor, për zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme vendore të datës 14.05.2023, për Kryetarë të bashkive;
- b. të nënshkruajë vetë ose të autorizojë persona të tretë për të nënshkruar, depozituar dhe për t'u paraqitur për përfaqësim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe organeve drejtuese në kuptim të nenit 12 të Kodit Zgjedhor në fuqi, pranë Kolegjit Zgjedhor apo pranë çdo gjykate për zgjidhjen e çdo problemi zgjedhor si dhe pranë të gjitha Komisioneve Zgjedhore për Administrimin e Zgjedhjeve (K.Z.A.Z) të përgjithshme vendore të datës 14.05.2023, për Kryetarë të bashkive, propozimet e Partisë Socialiste për anëtarë të K.Q.V-ve, anëtarë të G.N.V-ve, vëzhguesit në K.Z.A.Z, K.Q.V, V.N.V si dhe korrespondencën tjetër me K.Q.Z dhe K.Z.A.Z-të përkatëse, pa u kufizuar në të drejtën për të revokuar apo ndryshuar çdo autorizim të lëshuar;
- c. të nënshkruajë vetë ose të autorizojë persona të tretë për të nënshkruar çdo lloj kërkesë që nuk është përmendur këtu në kuadër të mbrojtjes së interesave zgjedhorë të P.S.SH përpara organeve të K.Q.Z për zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme vendore të datës 14.05.2023, për Kryetarë të bashkive;





NR prot 46

dt 28/03/2023



**PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE**  
**PARTIA SOCIALISTE E BASHKISE SARANDE**

Nr. 11 Prot.

Saranë, më, 28.03.2023

Lënda: Kerkojme mos rregjistrimin e kandidatit te propozuar nga zgjedhesit Gjergji Merkuri.

Drejtuar : KZAZ NR.90

SARANDE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.10019 date 29.12.2008 ,i ndryshuar , Kodi Zgjedhor si dhe Neni 14 i Vendimit Nr.5, date 20.11.2020 i Komisionit Rregullator,si dhe ne vijim te shkreses tone nr10 prot date 28.03.2023 ju veme ne dispozicion listen emerore me zgjedhesit te cilet kane hequr dore dhe kane revokuar mbeshtetjen per kandidimin e Gjergji Merkurit si kandidat i pavarur,me deklarata me shkrim te cilat i kemi depozituar prane KZAZ nr90.

1	Leonidha Zisi
2	Kreshnik Veli
3	Zorkadhe Veli
4	Kreshnik Dedaj
5	Margarit Lula
6	Elvana Lula
7	Pandeli Lula
8	Kalo Lula
9	Arten Sinani
10	Elsa Sinani
11	Petrit Sinani
12	Herta vasili
13	Hasho Vasili
14	Andrea Luzo
15	Margarita Luzo
16	Arkad Mejdani
17	Ednor Mejdani
18	Bilal Doko
19	Ervin Mejdani
20	Engjellushe Gerdhuqi


21	Arsela Mejdani
22	Enisilda Mejdani
23	Denis Sadikaj
24	Lula Shehu
25	Eduart Dautaj
26	Fjoela Dautaj
27	Anxhelo Sinomati
28	Eni Lugu
29	Shpetim Ligu
30	Zenepe Ligu
31	Ervin Dauti
32	Shpresa Doko
33	Manjola Lika
34	Miltiadh Shqevi
35	Mihail Bardho
36	Florie Bardho
37	Bajram bardho
38	Fatime Bardho
39	Shkelqim Bardho
40	Dhimiter Cobani
41	Blerina Osmani
42	Alfred Mucaj
43	Xheison Mucaj
44	Maria Lapa
45	Xhuliana Dorti
46	Elvin Hajdini
47	Barjame Hajdini
48	Rezarta Marku
49	Afroviti Izeti
50	Majlinda Demani
51	Nazmi Muka
52	Geraldo Demani
53	Engjell Shehu
54	Ilia Izeti
55	Silvana Koronaci
56	Qirjako Stefani
57	Arta Cobani
58	Marjna Jani
59	Spiro Jani
60	Laureta Dauti
61	Mikel Dauti
62	Josif Gerdhuqi
63	Markel Obzova
64	Xhevaire Dodi

65	Selame Zeneli
66	Jetmira Zeneli
67	Hate Zeneli
68	Kristo Cobani
69	Hasbi Seiti
70	Belipiana Necaj
71	Arjana Musa
72	Alqi Foti
73	Majlinda Foti
74	Sofika Muska
75	Besnik Hasipi
76	Antoneta Qirjazi
77	Qirjako Qirjazi
78	Qeiba Hizmo
79	Telo Hizmo
80	Aleksander Hizmo
81	Oltion Mane
82	Bejaze Mane
83	Eriol Llodoz
84	Manushaqe Llodoz
85	Beqir Mane
86	Sofika Muska
87	Alketa Lapa
88	Piro Lapa
89	Ksanthipi Lapa

**KRYETARI**  
**Partia Socialiste Bashkia Sarande.**  
**Eleron GJONI**



1<sup>v</sup> K prot 42  
28/03/2023



**PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE**  
**PARTIA SOCIALISTE E BASHKISE SARANDE**

Nr. 10 Prot.

Saranë, më, 28.03.2023

Lënda: Kërkojme mos rregjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit Gjergji Merkuri.

Drejtuar : KZAZ NR.90

SARANDE

Ne mbështetje të Ligjit Nr.10019 date 29.12.2008 ,i ndryshuar , Kodi Zgjedhor si dhe Neni 14 i Vendimit Nr.5, date 20.11.2020 i Komisionit Rregullator, ju drejtohem zyrtarisht për tju vene ne dijeni si me poshte :

1. Prane Partise Socialiste dega Sarande jane paraqitur me vullnetin e tyre te lire nje numer i konsiderueshem qytetaresh me banim ne Bashkine Sarande te perfshire ne listen e mbështetesve te kandidatit të propozuar nga zgjedhësit Gjergji Merkuri, te cilet kane deklaruar dhe kane depozituar shkreserisht deklaraten per revokim dhe heqje dore nga propozimi per mbështetjen e kandidatit Gjergji Merkuri me argumentimin se kete veprim e kane bere vetem per garen brenda Partise Socialiste per kandidat per Kryetar Bashkie dhe jo per kandidim si i pavaruar .
2. Ka zgjedhes te cilet jane te perfshire ne listat e mbështetesve te kandidatit te pavarur Gjergji Merkuri te cilet deklarojne se nuk kane neneshkruar personalisht listen e mbështetesve por kane mesuar qe gjenden ne ate liste si firmetare kunder vullnetit te tyre.
3. Ka zgjedhes te cilet ndodhen jashte shtetit prej vitesh dhe ndodhen ne listat e firmetareve te kandidatit të propozuar nga zgjedhësit Gjergji Merkuri .

Ne keto kushte kerkojme nga ana juaj verifikimin e ketyre fakteve dhe mosrregjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit Gjergji Merkuri per kandidim per Kryetar te Bashkise Sarande per zgjedhjet vendore te dates 14.05.2023.

Bashkangjitur po ju veme ne dispozicion dokumentacionin perkates.

**K R Y E T A R I**

**Partia Socialiste Bashkia Sarande.**

**Eleron GJONI**